



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:053224

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05474183

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.136/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Xhemajl JUSUFI, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita DËRGUTI, në lëndën penale ndaj të pandehurit R...A..., për shkak të veprave penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 3 nen paragrafi 3.1 të Kodi Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), dhe veprës penale Sulmi nga nenin 184 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.171/2022, të datës 28.02.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 22.02.2024 në prezencën e Prokurorit të Shtetit, Albana Parduzi, i pandehuri R...A..., mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare, avokat Festim Shala dhe dëmtuara L...A..., me datë 23.02.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 15.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

R...A..., me nofkën “D.”, nga i ati I..., e ëma Sh..., e vajzërisë H..., i lindur më datë 13.06.1993, në fshatin K... i M..., Komuna e Mitrovicës, ku edhe tani jeton në Rrugën “V...”, i pamartuar, ka të kryer shkollën 6 vite të shkollës fillore në shkollën speciale, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

-I-

Me datë 12.01.2022, rreth orës 19:25 në Rr. “V...”, në fshatin K... i M...-Mitrovicë me dashje dhe me forcë e sulmon të dëmtuarin-viktimën e ndjeshme-të miturën e moshës 11 vjeq A.Z dhe të dëmtuarën nënën e saj L...A... në atë mënyrë që, pasi që shkon në shtëpinë e të dëmtuarës L...-kunata e tij për të ngrënë bukë, aty e sulmon të miturën ku e godet me dorë dhe pasi që kryen veprimin inkriminues si në pikën II të dispozitivit ndaj të dëmtuarës L...A... e kap prapë të miturën me duar për flokë dhe e gjuan për tokë duke mos arrit të i shkaktojë lëndime trupore.

Me këtë ka kryer veprën penale: Sulmi nga neni 184 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të KPRK-së.

-II-

Në kohën dhe në vendin e lartcekur, e sulmon të dëmtuarën L...A... me mjet të rrezikshëm-thikë në atë mënyrë që, pasi kryen veprimin inkriminues si në pjesën e parë të dispozitivit I, e merr një thikë nga kuzhina dhe e sulmon të dëmtuarën duke mos arritur ta godas pasi që e njëjta e largon të pandehurin, i njëjti merr një dru të zjarrit dhe e godet në këmbë dhe pastaj e sulmon të dëmtuarën, të miturën A.Z. si më lartë në pjesën e dytë të dispozitivit I.

Me këtë ka kryer veprën penale: Sulmi nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 18, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70 e 184 të KPRK-së dhe nenit 364, 365, 366, 449, 452 dhe 462 të KPPK-së, i:

G J Y K O N

I. Për veprën penale sipas pikës I, Sulmi nga neni 184 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të KPRK-së, i cakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve.

II. Për veprën penale sipas pikës II, Sulmi nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, i cakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve.

Gjykata, në mbështetje të nenit 76 të KPRK-së, të pandehurit R...A... i:

S H Q I P T O N

- I. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej tetë (8) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit, në afat prej dy (2) vjetëve, nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.

Në bazë të nenit 83, 84 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 86 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2 e 1.3 dhe paragrafi 4 dhe 5 të KPRK-së, e lidhur me nenin 513 dhe 515 të KPP-së, të akuzuarit i shqipton:

**MASËN E TRAJTIMIT TË DETYRUAR PSIKIATRIK
NË LIRI**

- II. Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri ndaj të akuzuarit do të ekzekutohet në Qendrën e Shëndetit Mendor në Mitrovicë, të cilës masë i njëjti do t'i nënshtrohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

- III. DETYROHET i akuzuari që t'i nënshtrohet trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri në Qendrën e Shëndetit Mendor në Mitrovicë, në të kundërtën po që se nuk i nënshtrohet këtij trajtimi psikiatrik në liri apo ndërpret trajtimin në mënyrë arbitrare, gjykata konform nenit 86 paragrafi 5 të KPRK-së, mund të shqiptoj masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institutin psikiatrik.
- IV. DETYROHET Qendra e Shëndetit Mendor në Mitrovicë që pas fillimit të trajtimit, të informojë gjykatën çdo 6 muaj duke i paraqitur raportin me shkrim për mbarëvajtjen e këtij trajtimi të detyrueshëm psikiatrik ndaj të akuzuarit duke konstatuar se a është apo nuk është i nevojshëm trajtimi i detyrueshëm psikiatrik ndaj të njëjtit.
- V. Masa e trajtimit të detyruar psikiatrik do zgjasë derisa është në fuqi ky vendim gjyqësor dhe për aq kohë sa është nevojshme kjo masë dhe trajtimi i të akuzuarit, por jo me gjatë se tri (3) vite nga koha e shqiptimit të kësaj mase.
- VI. I pandehuri R...A..., lirohet nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale në këtë çështje gjyqësore.
- VII. Të dëmtuarat, A.Z dhe L....A... nga fshati K... i M..., Komuna e Mitrovicës, kanë hequr dorë nga kërkesën pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.171/2022 të datës 2022, kundër të pandehurit R...A... për shkak të veprave penale: Sulm nga neni 184 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të KPRK-së dhe veprës penale Sulm nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 15.01.2024, në të cilën seancë i akuzuari e ka pranuar fajësinë, mirëpo gjykata me aktvendim procedural ka refuzuar pranimin e fajësisë duke u bazuar në nenin 322 lidhur me nenin 242 dhe 513 të KPP-së, meqenëse është propozuar që ndaj të pandehurit të shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri gjykata ka konstatuar se është e nevojshme të dëgjohet edhe eksperti i psikiatrisë.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 30.01.2024 dhe 22.04.2024, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurori i Shtetit Albana Parduzi, i pandehuri R...A..., mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare, avokat Festim Shala dhe Eksperti i psikiatrisë forenzike, Dr. Jeton Zogaj nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë (IPFK) si dhe të dëmtuarat A.Z. dhe L.... A...

Në shqyrtim gjyqësor, si atë fillestar e po ashtu edhe atë kryesor, i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprat penale që i viheshin në barrë, ndërsa pasi është dëgjuar eksperti i psikiatrisë Dr. Jeton Zogaj në lidhje me gjendjen psikike të pandehurit R...A..., gjykata e ka refuzuar

pranimin e fajësisë dhe ka vazhduar me shqyrtimin gjyqësor, ka dëgjuar të dëmtuarën - dëshmitaren, L... A... dhe F... A..., ka administruar provat materiale dhe është dhënë fjala përfundimtare e palëve.

Gjykata, në shqyrtim kryesor, ka refuzuar pranimin e fajësisë për arsye sepse ka vlerësuar se nuk përmbushen kushtet nga neni 322 dhe 242 të KPP-së. Kjo për arsye sepse pas dëgjimit të ekspertit, Dr. Jeton Zogaj, i njëjti ka konstatuar se i pandehuri, për shkak të ngecjes në zhvillim dhe çrregullimit mendor, nuk është në gjendje të kuptoj benefitet dhe pasojat që rrjedhin nga pranimi apo mos pranimi i fajësisë, ashtu që pas deklarimit të ekspertit, gjykata ka vazhduar me shqyrtimin kryesor.

Fjala përfundimtare e palëve

Në fjalën përfundimtare, prokurori i shtetit ka deklaruar se: sa i përket pikës së II të dispozitivit të aktakuzës bëjmë një ndryshim të përshkrimit faktik ashtu që në rreshtin e katërt pas fjalëve “ pasi qe e njëjta” fshihet fjala “largohet”, dhe shtohet fjala “e largon te pandehurin, i njëjti merr një dru të zjarrit dhe e godet në këmbë”, pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar. Tutje, ka theksuar se konsideron se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mire se i akuzuari i kryer veprat penale si ne aktakuzë e cila gjendje faktike është vërtetuar nga dëshmia e të dëmtuarës - dëshmitares L...A... si dhe nga dëshmitari F... A... prandaj gjykatës i kërkuar që të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe ta dënoj sipas ligjit dhe gjithashtu gjykatës i ka propozuar që konform nenit 514 par.3 te KPP-se lidhur me nenin 84 par.1 nën par. 1.2 dhe te 86 te KPRK-se, te akuzuarit t’i shqiptoj edhe masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri në Qendrën e Shëndetit Mendor në Mitrovicë.

E dëmtuara L....A... në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se përkrahë fjalën e Prokurorit te Shtetit dhe nuk ka çfarë të shtoj.

Mbrojtësi i të pandehurit R...A..., avokat Festim Shala në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se gjatë konstatimit nga eksperti i IPFK-së, pa mëdyshje u vërtetua që i pandehuri e ka kryer veprën penale në gjendje të paaftësisë mendore dhe ndaj të njëjtit nuk mund vërtetohet fajësia andaj gjykatës i ka propozuar që ndaj tij të merr Aktvendim për trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në institucionin përkatës.

I pandehuri në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e mbështetë fjalën e mbrojtësit dhe nuk ka shtuar asgjë.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtura me datë 30.01.2024 dhe 20.02.2024, gjykata ka dëgjuar në cilësinë e ekspertit të psikiatrisë forenzike, Dr. Jeton Zogaj dhe në cilësi të dëmtuarës-dëshmitares L... A... dhe dëshmitarin F... A.....

Gjykata, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 30.01.2024, ka dëgjuar ekspertin e psikiatrisë Dr. Jeton Zogaj në lidhje me gjendjen psikike të pandehurit R...A..., se pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë sot në gjykatë para fillimit të kësaj seance të gjyqësore në lidhje me pjesëmarrjen e të akuzuarit në këtë seancë, ka theksuar se i njëjti mund të marrë pjesë në

seancë gjyqësore, mund të konsultohet me mbrojtësin e tij, e kupton deri diku procedurën gjyqësore që është duke u zhvilluar ndaj tij, mirëpo për shkak të natyrës së tij të çrregullimit nga i cili vuan deklaratat e tij mund të jenë të dëmtuara apo të shtrembëruara. Tutje, ka deklaruar se duke marrë për bazë natyrën e çrregullimit të pandehurit, pasi që kemi në çrregullimin në zhvillimin intelektual apo kufizimin kognitiv, emocional dhe social edhe po ashtu edhe për shkak të çrregullimit nga mosha fëmijërore siç është epilepsia e në veçanti prapambetja mendore apo ngecja në zhvillim e cila i prek fushat siç është vëmendja, të menduarit kujtesën i cili nuk është në gjendje ti kuptoj bene fitet apo pasojat e pranimi të fajësisë. Më tej ka shtuar se këto çrregullime kërkojnë që të monitorohen nga profesionistë të shëndetit mendor dhe trajtimin ne aspektin psikiatrik për më tepër është trajtim simptomatik, pasi që ato funksione janë të prekura nga mosha fëmijërore nuk mund të rikthehen, po ashtu duke marrë parasysh se i njëjti vuan edhe nga epilepsia, duhet të konsultohet me mjekun neurolog. Sa i përket nevojës për trajtim, i ka propozuar gjykatës që ndaj të njëjtit të shqiptohet masa e trajtim të detyruar psikiatrik në liri, masë kjo që do të mbikëqyret nga Qendra e Shëndetit Mendor në Mitrovicë, dhe nëse i pandehuri i përmbahet këshillave të profesionisteve, vlerëson që rreziku për përsëritjen e veprës penale do të jetë më i ulët dhe për respektimin e kësaj mase duhet ndihma e familjareve që të përcjellët gjendja e tij.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 22.02.2024, gjykata ka dëgjuar dëshmitaren L... A..., e cila ndër të tjera ka theksuar se të pandehurin e ka kunat, i njëjti jeton në shtëpinë e tij ndërsa ne jetojmë ne shtëpinë tone, atë ditë ka qene viti 2022, nuk i kujtohet saktësisht muaji ose dita i pandehuri ka ardhur te ne për ta marr bukën dhe pasi e ka ngrëne ushqimin ne shtëpinë e tij është kthyer përsëri te ne, dhe e ka kapur vajzën time A. për flokësh dhe e ka rrezuar ne toke, pastaj e ka goditur me dore ne pjesën e kokës, pastaj e ka marr thikën ne kuzhine dhe është nisur drejt meje, unë ja largova dorën ne mënyre qe te mos me godiste dhe pastaj e ka marr një dru për djegieje dhe me ka goditur me dru mua ne këmbë, te gjitha këto probleme janë si rezultat i problemeve shëndetësore përkatësisht mendore te cilat i ka R.....

Gjithashtu edhe dëshmitari F... A... gjatë shqyrtimit gjyqësor me datë 22.02.2024, ne mes të tjerash kishte deklaruar se punoj ne Trepçë, edhe ditën kritike unë kam qene ne ndërrimin e dyte pra kam qenë ne pune dhe kur ka ndodhur kjo ngjarje e kam pranuar një telefonate nga gruaja, L... qe jemi ne stacion te policisë, dhe menjëherë kam shkuar ne stacion te policisë ku veq kishin përfunduar procedurat përkatësisht marrja e deklaratave, e di qe prej asaj qe me kane treguar pastaj i pandehuri iu kishte sulmuar vajzën dhe kishte ndërhyrë edhe bashkëshortja mirëpo detaje nuk di sepse nuk kam qenë aty. i pandehuri vuan nga epilepsia, mirëpo një kohe është kujdesur babai për te dhe tash kujdesem unë, R.... përdor terapi te përshkruar nga mjeku, ai rrinë ne shtëpinë e vet por zakonisht ushqehet ne shtëpinë time., dua te them se jam ne mes te dy zjarreve për shkak se njërin ane kam gruan dhe vajzën ndërsa ne anën tjetër është ne pyetje vëllai im dhe për këtë arsye jemi ne telashe te mëdha.

Provat e administruara:

Gjykata, gjatë shqyrtimit gjyqësor, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike administroi provat si në vijim: Raporti i policit Emir Osmani, i datës 12.01.2022;

Procesverbali mbi marrjen ne pyetje i dëshmitares - dëmtuarës L....A..., i datës 12.01.2022; Procesverbali i marrjes ne pyetje ne polici, i te pandehurit R...A..., i datës 12.01.2022; Procesverbali i marrjes ne pyetje te dëshmitarit F... A..., i datës 12.01.2022; Raportet nga Emergjencia e Spitalit Te Përgjithshëm, i datës 20.07.2021 si dhe Raporti i Qendrës se Shëndetit Mendor, i datës 17.08.2021 për të pandehurin; Ekspertiza IPFK-se e datës 09.10.2023.

Pas dëgjimit të dëmtuarës dhe dëshmitarit dhe administrimit të provave materiale, i pandehuri nuk ka dhënë mbrojtjen e tij, respektivisht ka shfrytëzuar të drejtën e mbrojtjes në heshtje, ndërsa gjatë deklaratës së dhënë në polici me datë 12.01.2022 kishte deklaruar se jeton në shtëpinë e tij vetëm, ushqehet në shtëpinë e tij e ndonjëherë edhe në shtëpinë e vëllaut të tij F..... Tutje, ka shtuar se në ditën kritike kishte shkuar në shtëpinë e vëllaut të tij F.... dhe e kishte sulmuar vajzën e vëllait F..., e ka goditur me dorë në kry njëherë se ajo ma ka hi me një dru në këmbë dhe nuk e ka sulmuar L..... Më tej ka shtuar se vuan nga epilepsia (gërqi) dhe merr terapi, dhe ka premtuar se nuk do të bëjë probleme do të shkoj në shtëpinë e tij.

Vlerësimi i gjykatës:

Gjykata, pasi ka administruar provat personale dhe materiale, ka vërtetuara gjendjen faktike si në dispozitiv.

Për gjykatën nuk ishte kontestuese se me datë 12.01.2022, i pandehuri e kishte sulmuar të dëmtuarën të miturën A.Z dhe nënën e saj L....A..., në shtëpinë e tyre, duke e kapur për flokësh dhe goditur me dorë ne pjesën e kokës të miturën A.Z, kjo, përveç se vërtetohet nga dëgjimi i dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor, në fakt vërtetohet edhe nga vet deklarimi i të pandehurit lidhur me fajësinë, i cili është deklaruar fajtor për të dy veprat penale, por se gjykata kishte refuzuar pranimin e fajësisë për shkak se nga dëgjimi i ekspertit të IPFK-së, ishte konstatuar se i pandehuri nuk është në gjendje të kuptojë pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë, për shkak të gjendjes mendore të tij.

Po ashtu për gjykatën, nuk ishte kontestuese se i pandehuri e kishte sulmuar të dëmtuarën L... A... me mjet të rrezikshëm-thikë, por duke mos arritur ta godas pasi që e njëjta e largon të pandehurin, i njëjti merr një dru të zjarrit dhe e godet në këmbë.

Gjykata vëren se kontestuese në këtë çështje penale ishte nëse i pandehuri në kohën e kryerjes së veprës ka qenë në gjendje të mirë shëndetësore apo jo, përkatësisht, kontestuese nga ana e mbrojtësit të pandehurit, ishte nëse është arritur të vërtetohet fajësia e të pandehurit pasi që, siç ka pretenduar mbrojtësi, nga gjetjet dhe deklaratimet e ekspertit të IPFK-së, është vërtetuar se i pandehuri e ka kryer veprën në gjendje të paafësisë mendore.

Lidhur me këtë çështje, gjykata pas administrimit të provave një nga një dhe të gjitha së bashku, në kuptim të nenit 7 dhe 360 të KPP-së, ka vërtetuar përtej çdo dyshimi se i pandehuri ka kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike si në dispozitiv, gjykata e ka vërtetuar nga deklaratat e të dëmtuarës në cilësinë e dëshmitares, L...A..., të dhënë në shqyrtim gjyqësor e cila ka deklaruar se i pandehuri e ka kapur vajzën e saj A. për flokësh dhe e ka rrezuar në tokë, pastaj e ka goditur me dorë në pjesën e kokës, pastaj e ka marr thikën në kuzhinë dhe është nisur drejt saj, dëshmitarja ia ka larguar dorën në mënyrë që të mos e godiste dhe pastaj i pandehuri e ka marr një dru për djegie dhe e ka goditur me dru në këmbë.

Po ashtu edhe nga deklaratat e dëshmitarit F... A..., të dhënë në shqyrtim gjyqësor vërtetohet se ditën kritike unë kam qene në ndërrimin e dytë pra kam qenë në punë dhe kur ka ndodhur kjo ngjarje e kam pranuar një telefonatë nga gruaja, L... që jemi në stacion të policisë, dhe menjëherë kam shkuar në stacion të policisë ku veç se kishin përfunduar procedurat përkatësisht marrja e deklaratave, e di që prej asaj që më kanë treguar pastaj i pandehuri iu kishte sulmuar vajzën dhe kishte ndërhyrë edhe bashkëshortja mirëpo detaje nuk di sepse nuk kam qenë aty. i pandehuri vuan nga epilepsia, mirëpo një kohë është kujdesur babai për të dhe tash kujdesem unë, R... përdor terapi të përshkruar nga mjeku, ai rrin në shtëpinë e vet por zakonisht ushqehet në shtëpinë e tij.

Gjykata i vlerësoi dhe ia falë besimin deklaratave të dy dëshmitarëve, si deklaratat bindëse, konsistente dhe të qarta, në pajtim me gjendjen faktike të vërtetuar gjatë shqyrtimit të kësaj çështje penale, këto deklaratat ishin në pajtim me provat materiale por edhe në përputhje me vet deklarinimin e të pandehurit sa i përket fajësisë.

Gjithashtu këtë gjendje faktike, sa i përket gjendjes mendore të pandehurit, gjykata e vërtetoi edhe nga raporti i ekspertizës së IPFK-së i datës 09.10.2023, përmes të cilës është konstatuar gjendja shëndetësore ndaj të pandehurit R...A..., i cili vuan nga Çrregullimi në Zhvillimin Intelktual - kufizime në aspektin kognitiv, emocional dhe social, çrregullim ky i cili në Klasifikimin Ndërkombëtar të Sëmundjeve (ICD)-10 kodohet me F10 dhe Epilepsia G40 ICD-10.

Gjykata i ka besuar në tërësi kësaj prove materiale pasi që Ekspertiza IPFK-se e datës 09.10.2023, është përpiluar nga Dr. Jeton Zogaj ekspert pranë Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë dhe deklarinimit të dhënë në shqyrtim gjyqësor i cili ka deklaruar se i njëjti vuan nga Çrregullimi në zhvillimin Intelktual-kufizime në aspektin kognitiv, emocional dhe social, çrregullim ky i cili në Klasifikimin Ndërkombëtar të Sëmundjeve (ICD)-10 kodohet me F10 dhe Epilepsia G40 ICD-10, dhe propozimit për shqiptimin e masës së trajtimit të detyruar psikiatrik në Liri në Qendrën e Shëndetit Mendor në Mitrovicë.

Gjykata nuk mori për bazë pretendimet e mbrojtësit, i cili në fjalën përfundimtare ka theksuar se ndaj të pandehurit nuk mund të vërtetohet fajësia pasi që, siç ka pretenduar mbrojtësi, i pandehuri e ka kryer veprën në gjendje të paaftësisë mendore. Kjo duke u bazuar në faktin se i pandehuri nuk i ka kryer veprat penale në gjendje të paaftësisë mendore siç pretendohet, por në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore në shkallë esenciale, dhe kjo vërtetohet si nga raporti i IPFK-së, i datës 09.10.2023, ashtu edhe nga dëgjimi i drejtpërdrejtë i ekspertit në seancë të shqyrtimit kryesor.

Personat me aftësi esencialisht të zvogëluar mendore, janë penalisht përgjegjës dhe kjo duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 2 të KPRK-së, e cila dispozitë përcakton se: “2. *Personi i cili ka kryer veprë penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij/saj për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimeve ose mosveprimeve të tij/saj ka qenë esencialisht e zvogëluar për shkaqet e cekura në paragrafin 1. të këtij neni. Personi i tillë konsiderohet penalisht përgjegjës, por këto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masës së trajtimit të detyrueshëm.”. Në këtë kontekst, Gjkata në rastin konkret u bazua edhe në nenin 515 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale në të cilin përcaktohet se: “Kur gjykata merr aktgjykim ndaj personit i cili ka kryer veprë penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore, në atë aktgjykim ajo gjithashtu shqipton masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik nëse ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së tillë nga nenet 85 dhe 86 të Kodit Penal.”.*

Bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri me dashje, në gjendje të aftësisë esencialisht të zvogëluar ka kryer veprën Sulmi nga neni 184 paragrafi 3 nen paragrafi 3.1 të KPRK-së dhe veprës penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit ne mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Rrethana rëndësuese për të pandehurin në këtë çështje penale gjykata gjeti moshën e re të viktimës sipas pikës I të dispozitivit si dhe faktin se vepra është kryer brenda marrëdhënies familjare, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata gjeti pranimin e fajësisë si në seancën e shqyrtimit fillestar, ashtu edhe në atë kryesor (përkundër faktit se gjykata, për arsyet si më lart, ka refuzuar pranimin e fajësisë) rrethanat personale të pandehurit, përkatësisht shëndetin e tij, pasi që edhe nga raporti i shëndetit mendor është konstatuar se i njëjti ka një çrregullim të personalitetit, përkatësisht përgjegjësia e të pandehurit në kohën e kryerjes së veprës penale ishte esencialisht e zvogëluar.

Andaj mbi bazën e këtyre rrethanave të përcaktuara si më lart, Gjkata të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale me të cilën akuzohet i pandehuri dhe se Gjkata ka vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllim i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, se i akuzuari në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e paligjshme dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjkata duke marr për bazë rrethanat dhe gjendjen e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprave penale e mbi të gjitha rekomandimet dhe propozimin e ekspertit Dr. Jeton Zogaj vlerësoi si të domosdoshme vendimin mbi masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, me qëllim të rehabilitimit të të akuzuarit në mënyrë që të

arrihet në tërësi qëllimi i dënimit që i njëjti mos të kryej më vepra penale dhe përfundimisht të rehabilitohet, të mos jetë i rrezikshëm për rrethin ku jeton dhe në këtë mënyrë të eliminohet rreziku i përsëritjes së veprave penale. Gatishmëria dhe vullneti i të akuzuarit për tu trajtuar, dhe mundësia që përmes këtij trajtimi i njëjti mund të rehabilitohet dhe kështu të vazhdon jetën e tij normale, kanë bindur këtë gjykatë se kjo masë është e domosdoshme, andaj edhe gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi përkitazi me masën e trajtimit detyrueshëm psikiatrik në liri.

Gjykata në rastin konkret zbatoi nenin 515 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale në të cilin përcaktohet se: *“Kur gjykata merr aktgjykim ndaj personit i cili ka kryer veprë penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore, në atë aktgjykim ajo gjithashtu shqipton masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik nëse ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së tillë nga nenet 85 dhe 86 të Kodit Penal.”.*

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 4 të KPP-së, ashtu që e ka liruar të pandehurin nga shpenzimet e procedurës penale për arsye sepse i njëjti është pensionist invalidor andaj ngarkimi edhe me shpenzime të procedurës, do të rrezikonte ekzistencën në kuptim të mirëqenies përkatësisht gjendjes materiale të tij.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 462 të KPP-së ashtu që të dëmtuarin e ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 360, 364, 449, 450, 452 dhe 462 të KPP-së, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.136/2023 datë 15.03.2024

Zyrtarja ligjore
Doruntina BEKA

Gjyqtari
Xhemajl JUSUFI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.